

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët; Emine Mustafa, kryetare, Rasim Rasimi dhe Nesrin Lushta, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarve K.H. nga fsh. B., komuna e S., A.Sh. nga fsh. K.i P., komuna e S. dhe L.Z. nga fsh. R. e R., komuna e S., për shkak të veprës penale grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me para.1 dhe nenin 31 të KPRK, të dënuarit A.Sh. edhe për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK, duke vendosur sipas kërkesave për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësve të dënuarve K.H. dhe L.Z. av. G.R. dhe N.Sh., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.264/2017 datë 28.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.103/2018 datë 22.03.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 16.10.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të dënuarit K.H. dhe e mbrojtësit të dënuarit L.Z., të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.264/2017 datë 28.12.2017 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.103/2018 datë 22.03.2018.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin, PKR.nr.264/2017 e datës 28.12.2017, të dënuarit K.H., A.Sh. dhe L.Z. i ka shpallur fajtor për veprën penale grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPRK, ndërsa të dënuarin A.Sh. edhe për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK. Të dënuarit K.H. për veprën penale nën I të dispozitivit i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vitesh në të cilin dënim i ka llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej 20.03.2017 e tutje, i cili do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënim me gjobë në shumën prej 1.500 (njëmijë e pesëqind) €. Të dënuarit A.Sh.

për veprën penale nën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vitesh dhe dënim me gjobë në shumën prej 1.500 (njëmijepesëqind) € dhe për veprën penale nën II të dispozitivit të aktgjykimit dënimin me gjobë në shumë prej 5.00 (pesëqind) €. Konform nenit 80 par.2 pika 2.4 të KPRK, të dënuarit A.Sh. i shqipton dënim unik me gjobë në shumë prej 2.000 (dymijë) €. Të dënuarit L.Z., për veprën penale nën pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4 (katër) vite e 6 (gjashtë) muaj dhe dënimin me gjobë në shumën prej 1.000 (njëmijë) €. Nëse të dënuarit nuk dëshirojnë ose nuk mund të paguajnë dënimin me gjobë, gjykata ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim duke ia llogaritur një ditë burgim me 20 € të gjobës, me kusht që afati i burgimit të mos i kalojë 3 (tre) vjet, konform nenit 46 par.3 të KPRK. Janë obliguar të dënuarit që të paguajnë shpenzimet e procedurës penale aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, ndërsa shpenzimet në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga 100 €.Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil. Të dënuarve K.H. dhe A.Sh., iu është vazhduar paraburgimi derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar me këtë aktgjykim, ndërsa të dënuarit L.Z. i është ndërprerë paraburgimi, konform nenit 367 par.1 të KPPK.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.103/2018 e datës 22.03.2018, ka aprovuar ankesat e mbrojtësve të dënuarve dhe ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë përkritazi me vendimin mbi dënimin dhe të akuzuarit K.H. i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej 20.03. 2017 e tutje, të dënuarit A.Sh. i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vitesh në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 20.03.2017 e tutje dhe të dënuarit L.Z. i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite e 6 (gjashtë) muaj në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 20.03.2017 e deri me datën 28.12.2017. Në pjesët tjera aktgjykimi ka mbetur i paprekur. Me rastin e ankesës së mbrojtësit të dënuarit A.Sh. e sipas detyrës zyrtare, është ndryshuar aktgjykimi i shkallës së parë, për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 374 par.1 të KPRK, dhe i dënuari konform nenit 364 par.1 nënpar.1.3 të KPPK, është liruar nga akuza.

Kundër këtyre aktgjykimeve kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë kanë paraqitur:

mbrojtësi i të dënuarit K.H. av. G.R. nga Mitrovica, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë në tërsi kërkesën dhe ti anuloj aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështjen t'ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rivendosje,

mbrojtësi i të dënuarit L.Z. av. N.Sh.nga Prishtina, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën, ti ndryshoi aktgjykimet e kundërshtuara dhe të bie vendim lirues.

Përgjigje në kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur Prokurori i Shtetit, me parashtresën KMLP.nr.139/2018 e datës 09.08.2018, me propozim që kërkesat të refuzohen si të pabazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit i shqyrtoi të gjitha shkresat të çështjes konform dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK, dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjeti se:

Kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk janë të bazuara.

Mbrojtësi i të dënuarit K.H., av. G.R., në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e shkallës së dytë kanë bërë shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPK, sepse në arsyetimin e aktgjykimit nuk janë paraqitë qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh gjykata i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara e në mënyrë të veçantë nuk e kanë vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse. Edhe pse në dispozitiv të aktgjykimit është konstatuar se automjeti “O....” ngjyrë hiri, është pronë e familjes H., e të cilin fakt mbrojtja e ka kontestuar fuqishëm, as gjykata e shkallës së parë e as gjykata e shkallës së dytë nuk japin fare arsye se me cilat prova e kanë vërtetuar pronësinë e këtij automjeti. Më pastaj në kërkesë pretendohet se identifikimi i personave është bërë në kundërshtim me dispozitën e nenit 120 të KPPK. Nga fotoalbumi i policisë janë prezantuar fotografitë, ku shihen të parkuara dy automjete njëri i markës “...” dhe tjetri i markës “O...” dhe nuk shihen targat e regjistrimit. Sipas deklaratave të dëshmitarëve, identifikimi i personave është me besueshmëri për 90-95% përkatësisht 70-80% për të dënuarit K. e A. Këto vlerësime të gjykatës së shkallës së parë nuk janë bindëse, janë të dyshimta dhe në këto dëshmi nuk mund të mbështetet aktgjykimi. Sipas kërkesës, si pasojë e këtyre shkeljeve, është shkelur ligji penal në dëm të dënuarit, për arsye se nuk është vërtetuar me asnjë provë se i dënuari K.H. ka kryer veprën penale për të cilën është shpallur fajtor.

Mbrojtësi i të dënuarit L.Z. av. N.Sh. në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimet e kundërshtuara përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes të ligjit penal, sepse dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë dhe të dytë janë të pakuptueshëm, kundërthënës me arsyet e aktgjykimi ngase nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare, kurse arsyet e paraqitura janë plotësisht të paqarta dhe kundërthënëse, për faktet vendimtare ka kundërthënie të konsiderueshme ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit në përmbajtjen e shkresave të lëndës mbi deklaratimet e palëve të dhëna në procedurë. Një formulim i dispozitivit të aktgjykimeve të kundërshtuara lidhur me të dënuarin L.Z. assesi nuk mund të qëndrojë sepse me asnjë provë relevante qoftë formale apo materiale, nuk është vërtetuar dashja qoftë direkte apo indirekte për kryerjen e veprës penale grabitje nga neni 329 par.3 lidhur me par.1 dhe nenin 31 të KPPK. Me asnjë provë nuk është vërtetuar se ditën kritike kur ka ndodhur ngjarja, në vendin e ngjarjes nuk ka qenë fare prezent, i dënuari. Alibinë e vërtetojnë të dënuarit K.H. dhe A.Sh., pastaj të dëmtuarit Rr. dhe R.G. si dhe dëshmitari L.M., të

cilët në mënyrë publike kanë deklaruar se ditën kritike fare nuk e kanë parë të dënuarin L. Në kërkesën e mbrojtësit pretendohet se gjykata e shkallës së parë, ka shkelur ligjin penal në dëm të dënuarit ,sepse të gjitha rrethanat e rastit vërtetojnë se ai nuk kryes i veprës penale, siç ka gjetur gabimisht gjykata e shkallës së parë dhe ka vërtetuar gjykata e shkallës së dytë.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se pretendimet e mbrojtësve të dënuarve K.H. dhe L.Z., janë të pabazuara.

Siç rezulton nga shkresat e çështjes, aktgjykimi i shkallës së parë i vërtetuar me aktgjykimin e shkallës së dytë, është i qartë dhe konkret, ngase në dispozitiv janë paraqitur të gjitha veprimet inkriminuese të dënuarve që përbëjnë elementet objektive dhe subjektive të veprës penale për të cilën janë shpallur fajtor të dënuarit. Gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme për fakte vendimtare duke vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vendosjes së kësaj çështje penalo-juridike, e sidomos me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale.

Nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i kundërshtuar rezulton se të dënuarit K.H., A.Sh. dhe L.Z., e që gjykata drejt ka vlerësuar kanë vepruar në grup, dhe të njëjtit kanë përdorë forcën me përdorimin e çekanit e të cilat veprime inkriminuese janë përshkruar në dispozitivin e aktgjykimit. Gjykatat kanë gjetur se me automjetin të tipit “F...”, në të cilin kanë qenë të dëmtuarit R. dhe Rr.G., është bërë transportimin e parave, të cilat para i kanë mbledhur nga pikat shitëse të A...., për ti dorëzuar në Raiffesen Bankë, ashtu që automjeti me të cilin kanë lëvizur të dëmtuarit në dalje të nënkallimit të fshatit H., të dënuarit K. dhe A. me veturën e tipit “O...” Karavan kanë bllokuar rrugën, dhe në atë moment i dënuari A. i është afruar automjetit për transportim të parave, ka dalë nga ana e pasagjerit të dëmtuarit Rr.G. duke ia thyer xhamin e veturës, duke e kanosur, ndërsa i dënuari K.H., ia ka thyer xhamin e automjetit nga ana e ngasësit, me çekan metalik, me të cilin e ka goditur në kokë të dëmtuarin Rr.G. dhe ka arritur që nga të dëmtuarit ta merr çantën me një shumë parash të qarkullimit ditor dhe janë larguar ndërsa në vendin e ngjarjes ka mbetur vetëm çekani. I dënuari L.Z. me automjetin e tipit “B..” ngjyrë e zezë, me targa të regjistrimit, i ka përcjell lëvizjen e automjetit të tipit “F...”, ngjyrë të bardhë me targa të regjistrimit, me të cilin automjet të dëmtuarit R. dhe Rr.G. kanë bërë transportimin e parave, veprime këto të cilat janë vërtetuar edhe me deklaratën e dëshmitarit L.M. i cili ka deklaruar se në autolarjen e tij në parking është ndalë vetura “B..” e të dënuarit L.Z. i cili kinse ka pasur probleme teknike, ku ka ndejtë rreth 10 minuta, e pastaj është larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim të Pejës, për në fshatin H., dhe i dënuari ka mbajtur kokën të kërrusur dhe mbante një kapelë në kokë me strehë e me qëllim që ta fsheh fytyrën, dhe vet i dënuari L.Z. e pranon se ka qenë në auto parkingun e L.M. Në polici ka deklaruar se ka qenë në autolarje te parkingu, e kjo vërtetohet edhe në deklaratën e të dënuarit K.H., i cili ka deklaruar se veturën “B...” pronë e familjes së tij ia ka dhënë në shfrytëzim të dënuarit L.Z. dhe gjykata ka nxjerr përfundim të drejt se të dënuarit kanë qenë në grup kanë përdor forcë ndaj të dëmtuarve R. dhe Rr.G., të gjitha veprimet të dënuarit i kanë marrë në bashkëveprim me njëri tjetrin.

Gjykata e shkallës së parë vlerësimin e provave e ka bërë në pajtim e me dispozitat e nenit 361 par.2 të KPPK kurse, për provat kontradiktore ka vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 370 par.7 të KPPK, duke paraqitur në mënyrë të qartë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i merr si të provuara ose si të pa provuara, duke bërë vlerësimin e provave kontradiktore. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të qarta për vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës penale, e po ashtu e ka marrë parasysh edhe mbrojtjen e të dënuarve e cila mbrojtje dhe kundërthënëse njëra me tjetrën në fazat e ndryshme të zhvillimit të kësaj procedure penale, duke konstatuar se të njëjtët nuk e kanë pranuar kryerjen e veprës penale që u vihet në barrë, mbrojtje të cilën gjykata me të drejtë e ka vlerësuar si të pa bazë dhe të paargumentuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimi është i qartë dhe i kuptueshëm dhe gjykata ka dhënë arsye të qarta dhe të plota lidhur me faktet vendimtare të cilat janë cekur edhe më lartë, e kjo mbështetet në atë se të dënuarit kanë vepruar në grup, se kanë përdorur mjete të përshtatshme për shkaktimin e lëndimeve dhe kanë pasur marrëveshje paraprake për të kryer veprën penale për të cilën janë shpallur fajtor, e kjo mbështetet në atë se të dëmtuarit R. dhe Rr.G. kanë bërë identifikimin e të dënuarve K. dhe A. Të dëmtuarit kanë deklaruar se 90-95 %, përkatësisht 70-80%, janë të sigurt se të dënuarit K. dhe A. kanë qenë personat që i kanë sulmuar atë ditë, për gjykatën, kjo shkallë e besueshmërisë së të dëmtuarve, është e mjaftueshme për të ardh në përfundim, se të dënuarit e kanë kryer veprën penale ngase ngjarja është zhvilluar shumë shpejtë, të dëmtuarit kanë qenë të sulmuar atëçastshëm me mjet të rrezikshëm, sulmuesit kanë ardhë nga anët anësore të automjetit. Kjo shkallë e lartë e besueshmërisë së të dëmtuarve se vërtetë këta persona janë sulmuesit në ditën kritike, është në pajtueshmëri të plotë edhe me procesin e identifikimit të të dënuarve, në fazat e mëhershme të zhvillimit të kësaj procedure penale, pra edhe me rastin e prezantimit të fotografive të të njëjtëve edhe me prezantimin fizik të tyre dhe se këto identifikime janë bërë konform dispozitave ligjore të KPPK. Të dëmtuarit kanë arritur të bëjnë një përshkrim të përafërt të figurave të këtyre dy personave, ku shihet se njëri vërtet është më zeshkan dhe më i gjatë, deri sa tjetri është më i plotë, më i shkurt dhe më i bardhë. Andaj, bazuar në këto fakte të theksuara më lartë, gjykata drejt i ka vlerësuar këto dëshmi si dëshmi reale, objektive, të sinqerta dhe në pajtueshmëri të plotë njëra me tjetrën, të dhëna në të gjitha fazat e zhvillimit të këtij procesi, andaj pretendimet e mbrojtësve të dënuarve në këtë drejtim janë të pabazuara. Po ashtu me ekspertizën mjeko ligjore është vërtetuar se të dëmtuarit R. dhe Rr., kanë pësuar lëndime trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, e të shkaktuara nga mjete mekanik që nënkupton se është përdorur çekani, e këto mbështeten edhe me listën e dëshmive, nga fotografitë ku shihen xhamat e thyera të veturës “F...”, nga raporti njoftues i datës 22.03.2017, së bashku me fotografitë e nxjerra nga video incizimet e kompanisë A...P, nga të cilat vërtetohet fakti se automjetet e tipit “O...” dhe “B..” që kanë qenë të involvuara me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale, kanë qenë në lëvizje në regjionin ku është kryer vepra penale, në afërsi të A..P. e të parkuara te parkingu i një objekti pas parkingut të autolarjes në drejtim të Pejës e të gjitha këto lëvizje janë të përafërta me kohën e kryerjes së veprës penale, pra lëvizjet e këtyre automjeteve janë prej orës 09.47 minuta deri në ora 10.21, min. kohë kjo brenda së cilës është kryer vepra penale.

Pretendimet e mbrojtësve të dënuarve përkitazi me shkeljen e ligjit penal në dëm të dënuarve, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndrojnë. Gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë drejtë kanë aplikuar ligjin penal dhe drejt kanë vërtetuar se të dënuarit ditën kritike me datë 13.03.2017 në grup e me marrëveshje paraprake me njëri tjetrin, me përdorimin e forcës e me qëllim që vetit ti sjellin përfitim pasuror të kundërligjshëm, kanë ndërmarr veprimet të cilat më lartë u përshkruan, ashtu që me shpalljen fajtorë të tyre, ligji penal nuk është shkelur.

Vlen të theksohet se konkludimet e të dy gjykatave lidhur me përshkrimin faktik dhe cilësimin juridik të veprës penale për të cilën të dënuarit janë shpallur fajtor janë rezultat i vlerësimit drejtë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësor kështu që asnjë fakt nuk ka ngelur dubioz ose i pavërtetuar dhe si rrjedhojë, drejt është aplikuar ligji penal.

Nga të gjitha këto që u thanë më lart, kjo Gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të dënuarve, andaj kërkesa e mbrojtësve të dënuarve është refuzuar si e pabazuar dhe konform nenit 437 të të KPPK, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Pml.nr.191/2018, më datë 16.10.2018

Procesmbajtës,
Bujar Balaj

Kryetare e kolegjit,
Emine Mustafa